

**KLSH merr pjesë në akademinë “Qeverisja e Institucioneve Supreme të Auditimit”,
organizuar nga INTOSAI DEVELOPEMENT INITIATIVE (IDI)
në Tbilisi, Gjeorgji**

U zhvillua në Tbilisi, Gjeorgji në datat 27 nëntor 2023 - 1 dhjetor 2023, akademia e organizuar nga IDI “Qeverisja e institucioneve supreme të auditimit”.

Në fokus të zhvillimit të këtij aktiviteti ishte përmbushja e disa objektivave specifike, si më poshtë vijon:



- Përcaktimi i bazave të menaxhimit strategjik që një SAI-të duhet të zotërojë;
- Kuptueshmëria dhe përcaktimi nga ana e SAI-ve për proceset dhe mjetet më të përshtatshme organizative për të avancuar në performancën e tyre;
- Udhëheqja efektive dhe performanca e ekipit;
- Përvetësimi i perspektivave të reja mbi përcaktuesit kryesorë të qeverisjes së Menaxhimit të Financave Publike dhe digitalizimit.

Ekspertët e IDI-t gjatë ditëve të aktivitetit zhvilluan disa leksione të zgjeruara dhe raste studimore specifike për secilën temë përkatëse, me qëllim përfshirjen e të gjithë pjesëmarrësve duke i mundësuar veçanërisht audituesve të krijojnë njohuri mbi ndërveprimin në mënyrë efektive për qeverisjen e SAI-t, në tre nivele: si individë, si pjesë e organizatës dhe si pjesë integrale e sektorit publik.

U diskutuan raste studimore konkrete mbi planifikimin strategjik, planifikimin operacional, inteligjencën emocionale, transformimin digjital, duke përfshirë edhe inteligjencën artificiale në auditim, si dhe menaxhimin e financave publike (PFM).

Në këtë veprimtari morën pjesë përfaqësues të *Institucioneve Supreme të Auditimit* nga Shqipëria, Gjeorgjia, Gana, Indonezia, Kenia, Tunizia dhe Turqia.

Kontrulli i Lartë i Shtetit u përfaqësua me znj. Anjeza Gjoci dhe znj. Erikliida Shpori, audituese pranë Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore.